

RREGULLORE
Nr. 2, datë 10.12.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
PËR PAJISJEN ME LEJE DHE TË
KONKURRIMIT PUBLIK PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
AKUAKULTURËS TOKËSORE DHE
UJORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës nenit 32 të ligjit nr. 7908, datë 05.04.1995, “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave miraton rregulloren si më poshtë.

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për zhvillimin e konkurrimit publik për akuakulturën tokësore dhe ujore.

Neni 2
E drejta për zhvillimin e aktivitetit të
akuakulturës

Personat fizikë ose juridikë të interesuar për zhvillimin e akuakulturës, tokësore dhe ujore, në pronat publike, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik. Me fituesin, Ministria ose përfaqësuesi i pronës shtetërore lidh kontratë qiraje. Procedurat për lidhjen e kontratës dhe ato të konkurrimit publik nuk zbatohen në rastet kur toka është në pronësi private.

Neni 3
Aplikimi dhe kërkesat për konkurrimin publik
për aktivitetin e akuakulturës

1. Kryerja e procedurave të konkurrimin publik për zhvillimin e akuakulturës tokësore dhe ujore detare, realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave, i ngritur me Urdhër Ministri i cili ka detyra dhe kryen procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 712, datë 31.07.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”.

2. Drejtoria që mbulon peshkimit grumbullon, regjistron, verifikon kërkesat e ardhura për zhvillim aktiviteti në akuakulturë, së bashku me statusin e objektit ujqor të kërkuar. Objektet ujore, pasi seleksionohen dhe kategorizohen, renditen në listën për shpallje për konkurrim publik.

3. Drejtoria që mbulon peshkimin krijon një data-bazë elektronikë të të gjitha kërkesave të ardhura duke specifikuar emrin e kërkuarit, datën, zonën, llojin e aktivitetit të kërkuar, si dhe mbylljen e praktikës.

4. Njoftimi për botim për konkurrim të akuakulturës shpallet 2 herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban të dhënat për objektin ujqor, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacionin që duhet të paraqesin konkurrentët, si dhe vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

5. Drejtoria që mbulon peshkimin, mban një listë (që përditësohet vazhdimisht) të subjekteve që rezultojnë kundërvajtës i legjislacionit në fushën e akuakulturës dhe/ose debitorë, me qëllim që të mbahet parasysh në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit për konkurrim nga ana e komisionit të vlerësimit të kërkesave.

6. Lista finale e objekteve ujore e përgatitur nga drejtoria që mbulon peshkimin si dhe lista e subjekteve fituese dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike nëpërmjet sektorit të prokurimeve publike.

7. Dokumentacioni i përgjithshëm që paraqesin pjesëmarrësit në konkurrim është:

a) kërkesa për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës në objektin ujqor të shpallur për konkurrim;

b) regjistrimin në QKR për objektin e veprimtarisë së bashku me ekstraktin historik;

c) plan biznesi për zhvillimin e veprimtarisë;

d) projekti teknik, teknologjik;

e) të dhëna për nivelin e investimit;

f) të dhëna për nivelin i punësimit;

g) vetëdeklarim se projekti përputhet me kërkesat mjedisore të zonës në fjalë;

h) vërtetim nga organet tatimore që subjekti në fjalë nuk ka detyrime tatimore;

i) vërtetim se subjekti ka aplikuar pranë strukturave mjedisore për t’u pajisur me leje mjedisore (vetëm për rastet e akuakulturës intensive);

j) Deklaratën mbi konfliktin e interesit.

8. Dokumentacioni i veçantë që paraqesin pjesëmarrësit në konkurrim për çdo kategori ujore është:

a) për akuakulturën:

i) prania e specialistit të fushës nëpërmjet CV profesionale, ku të tregohet kualifikimi dhe përvoja në fushën e peshkimit dhe akuakulturës;

ii) planvendosja e shprehur në koordinata

gjeografike për sipërfaqet detare apo një hartë me ngjyra me emrat e toponimeve të objekteve kufizuese;

iii) Garancia financiare, e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.

b) grumbullim/kultivim molusqesh bivalvore:

i) kategorizim nga autoriteti veterinar i zonës;

ii) lista dhe vendosja e të gjitha derdhjeve ujore nga toka në det në raport me zonën ku synohet të zhvillohet aktiviteti, e paraqitur në hartë topografike me shkallën 1: 25 000 me ngjyra;

iii) llojet që synohen të kultivohen ose grumbullohen;

iv) kontratë paraprake me një qendër depurimi, nëse synohet të tregtohet e gjallë dhe ose kontratë me një qendër përpunimi termike të certifikuara nga AKU-ja;

v) garancia financiare, e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.

c) Për kultivimin e midhjes në impiante fikse në liqenin e Butrintit:

i) kontratë paraprake me një qendër depurimi, nëse synohet të tregtohet e gjallë dhe/ose kontratë me një qendër përpunimi termike, të certifikuara nga AKU-ja;

ii) elementet kryesorë të teknologjisë që do të praktikojë në kultivimin e midhjes;

iii) vërtetim që nuk kanë detyrime të mëparshme ndaj MMPAU (taksa e lejes e provuar nga mandat pagesat në vite, kontrata qiraje, etj);

iv) garancia financiare, e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.

Neni 4

Kriteret e konkurrimit

Kriteret e konkurrimit për të gjitha kategoritë ujore janë:

a) Niveli i investimit, në raport të drejtë me kapacitetet dhe resurset e zonës ku do të zhvillohet aktiviteti;

b) Teknologjia e projektit;

c) Niveli i punësimit.

Neni 5

Nivelet e vlerësimit

1. Nivelet maksimale të vlerësimit për të gjitha kategoritë ujore janë:

a) Niveli i investimit;

b) Teknologjia e projektit;

c) Niveli i punësimit;

d) Në rast kualifikimi me pikë të barabarta, CV-ja e subjektit dhe eksperiencia në aktivitet ka përparësi.

2. Detaji i kriterëve të vlerësimit bëhet sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje.

3. Monitorimi i moszbatimit të kushteve të kësaj kontrate dhe zbatimit të plan bizneseve të paraqitura në konkurrim është detyrë e monitoruesve të drejtorisë që mbulon peshkimin.

4. Një kopje e planbiznesit të paraqitur për konkurrim nga subjekti fitues depozitohet në drejtorinë që mbulon peshkimin për t'u përdorur në monitorimin e aktivitetit sipas pikës 3 të këtij neni.

Neni 6

Ankimi

Subjektet konkurruese, brenda 7 ditëve kalendarike nga shpallja e subjektit fitues në APP, kanë të drejtën e ankimit me shkrim te ministri, i cili brenda 10 ditëve kalendarike shprehet me shkrim.

Neni 7

Mbyllja e procedurës

1. Kontratat për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës përgatiten nga drejtoria që mbulon peshkimin sipas modelit të kontratës tip të përcaktuar në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje;

2. Pas përfundimit të procedurave të mësipërme, Ministria lidh kontratën për zhvillimit e aktivitetit të kërkuar dhe të miratuar në procesin e konkurrimit me subjektin fitues brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe miraton kohëzgjatjen e projektit/kontratës.

3. Kohëzgjatja e kontratës është:

a) jo më shumë se 10 vjet për akuakulturën intensive;

b) jo më shumë se 5 vjet për impiantet e midhjeve në Butrint.

Neni 8

Rinovimi i lejes për aktivitet akuakulture

Me mbarimin e afateve të lejuara sipas formatit të lejes ose kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës, çdo subjekt akuakulture duhet të aplikojë nga fillimi për të fituar të drejtën e zhvillimit të aktivitetit të akuakulturës.

Neni 9

Ndërprerja e lejes dhe prishja e kontratës

1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit, ndërprerja e vlefshmërisë së lejes dhe prishja e kontratës për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës bëhet mbi bazën e konstatimeve të kundërligjshme dhe mosrespektimit të kushteve të kontratës. Konstatimet nga inspektoriat i peshkimit pasqyrohen në akte të shkruara, në të cilin bëhet edhe propozimi për prishjen e njëanshme të

kontratës. Kontrata prishet edhe në rast se subjekti ka dhënë deklarime ose dokumentacion të rremë në konkurrimin, mbi të cilat është shpallur fitues, duke pasur efekt prapaveprues.

2. Vendimi i Komisionit për ndërprerjen e kontratës i lëshohet me shkrim subjektit të kontraktuar.

3. Zotëruesi i lejes/kontratës është i detyruar të dorëzojë pranë inspektorit të peshkimit ose zyrës së inspektoratit të peshkimit në rrethin përkatës dokumentin e lejes/kontratës.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

SHTOJCA 1
TABELAT ORIENTUESE TË VLERËSIMIT

Për akuakulturën

Niveli i investimit	Gjithsej		40 pikë
	Garancia bankare	1 vit vlere e investimit	10
		2 vjet vlere e investimit	20
		4 vjet vlere e investimit	30
		6 vjet vlere e investimit	40
Teknologjia e projektit	Gjithsej		40 pikë
Respektimi i kushteve mjedisore dhe statusi i zonës	Thellësia e detit ku do instalohet (akuakulturë me kosha notues)	Deri në 40 metra	10
A		Mbi 40 metra	20
B	Akuakultura tokësore	Gjithsej	20
		Cikël i plotë	20
		Cikël i pjesshëm	15
Niveli i punësimit	Gjithsej		20 pikë
	Forma juridike e shoqërisë		6
	Specialistë të fushës si drejtues të projektit, (0- 10 vjet eksperiencë)		1-7
	Numër punonjësish ¹		1-7

Për akuakulturën e midhjeve me impiante fikse në Butrint

Niveli i investimit	Gjithsej		40 pikë
	Garancia bankare	2 vjet vlere e investimit	20
		3 vjet vlere e investimit	30
		4 vjet vlere e investimit	40
Teknologjia e projektit	Gjithsej		40 pikë
	Funksionim i impiantit me kapacitet të plotë dhe mirëmbajtja e tij.		15
	Grumbullimi i farës		3
Procesi teknologjik i kultivimit të midhjeve		Ajrosja e midhjeve dhe sigurimi i një produkti cilësor	2
		Kalimi nëpërmjet një Qendre të Autorizuar nga AKU	10
		Kokërzimi, paketimi dhe etiketimi	6

¹ Në ofertën e paraqitur pikët maksimale i merr ai që ka deklaruar numër më të madh punonjësish, ndërsa konkurrentët e tjerë në raport të 7, kundrejt numrit të paraqitur (p.sh. konkurrenti I: 10 punonjës, konkurrenti II = 9 punonjës. Pikët: konkurrenti I = 7 pikë, konkurrenti II= 9x7:10 =6.3 pikë).

		Përpunimi dhe shitja e produktit vetëm subjekteve të njohura nga AKU2.	4
Niveli i Punësimit	Gjithsej		20 pikë
	Forma juridike e shoqërisë		5
	Eksperienca në kultivimin e midhjeve		1-10
	Numër punonjësish për impiant		1-5

SHTOJCA 2
KONTRATA TIP PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT TË AKUAKULTURËS
KONTRATË
PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË AKUAKULTURËS
(Akuakulturë intensive detare)

Nr. ...Prot ose Nr.Kontratës

E lidhur sot më datë . . 2014, midis palëve si më poshtë:

Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, (MBZHRAU) përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm, z. Vojo Bregu, me seli: blv. “Dëshmoret e Kombit”, nr. 2, Tiranë, - tel: 04 2227916, fax: 04 2227916

dhe

Subjektit juridik/fizik: _____sh.p.k., me numër NIPTI:_____, me adresë: _____, përfaqësuar administratori z. _____, mbajtës i leternjoftimit nr._____,

BAZA LIGJORE: ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, neni 659 e vijues, ligji nr. 7908, datë 5.4.1995, “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar, VKM nr. 547, datë 13.5.2009 “Për përcaktimin e procedurave dhe vlerave të qerasë për sipërfaqet ujore, për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”, rregullores nr. 2, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e procedurave për pajisjen me leje dhe të konkurrimit publik për ushtrimin e akuakulturës tokësore dhe ujore”,

Palët kontraktuese ranë dakord të nënshkruajnë kontratën me përmbajtje si më poshtë:

Neni 1

Objekti i kontratës

Kjo kontratë ka për qëllim zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës në det të hapur nga ana e subjektit juridik _____, në objektin ujor: _____, me sipërfaqe _____ m², në komunën _____ rrethi_____, qarku _____, i shpallur fitues nga ana e Ministrisë në konkurrimin publik të zhvilluar me datë _____.

MBZHRAU i njeh të drejtën e zhvillimit të aktivitetit të akuakulturës intensive, subjektit_____ brenda të gjithë kuadrit ligjor që rregullon këtë aktivitet, në zonën e përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 1.

² Shitja e produktit subjekteve që e nxjerrin në breg të liqenit ose nxjerrja e tij në breg të liqenit nga vetë subjekti çon në mospërputhje me kushtet e kontratës.

Neni 2
Afati i kontratës

Kjo kontratë fillon nga data e nënshkrimit të saj nga Palët dhe ka një afat 10 –vjeçar (dhjetëvjeçar). Me përfundimin e afatit të saj kjo kontratë konsiderohet e zgjidhur.

Neni 3
E drejta e peshkimit

Subjekti juridik/fizik gëzon të drejtën të zhvillojë aktivitetin e akuakulturës në objektin ujor _____, me sipërfaqe _____, komuna _____, rrethi _____, qarku _____, në zonën me koordinata:

	Kufizimet	Koordinatat
Veri	X _____ N	Y _____ E
Jug	X _____ N	Y _____ E
Lindje	X _____ N	Y _____ E
Perëndim	X _____ N	Y _____ E

Neni 4
Pagesa dhe regjimi i saj

1. Subjekti juridik/fizik _____ do të kryejë pagesën mbi të drejtën e zhvillimit të aktivitetit të akuakulturës, në vlerën e përcaktuar nga shtojca 4 e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, për llogari të degës së Tatimeve, Tiranë në numrin e llogarisë: 0108030785 .

2. Pagesa e parë do të kryhet menjëherë, në momentin e nënshkrimit të kontratës sipas kushteve të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 6 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

3. Pagesat në vitet e tjera do të kryhen brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese

Subjekti juridik/fizik _____ zbaton detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, si më poshtë:

Për akuakulturën detare, në sipërfaqen prej _____, me koordinata:

	Kufizimet	Koordinatat
Veri	X _____ N	Y _____ E
Jug	X _____ N	Y _____ E
Lindje	X _____ N	Y _____ E
Perëndim	X _____ N	Y _____ E

Në njësinë administrative të: komuna _____, rrethi _____, qarku _____,

MBZHRAU nëpërmjet strukturave të saj, merr masa brenda kompetencave ligjore, për të siguruar respektimin e të drejtës së ushtrimit të aktivitetit, që i është dhënë subjektit të mësipërm, nëpërmjet kësaj kontrate.

MBZHRAU gëzon të drejtën ligjore të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e subjektit për:

1. Fillimin e investimeve brenda afatit ligjor prej 6 muajsh;
2. Realizimin e investimeve në vite, sipas treguesve të deklaruar nga ana e tij në dokumentin e nivelit të investimeve apo planbiznesin e paraqitur në aplikimin si kërkues për leje të aktivitetit të

akuakulturës;

3. Aktverifikimin e investimeve të dokumentuar dhe të plotësuar nga ana e investitorit dhe subjektit që ushtron aktivitetin. Raporti i organit kompetent të ngarkuar për inspektim;

4. komunikimin rregullisht të deklarimeve statistikore pranë strukturave lokale deri më 31 mars të vitit në vazhdim;

5. për respektimin e legjislacionit të peshkimit dhe të akuakulturës;

6. respektimin e legjislacionit, veçanërisht respektimin e koordinatave të sipërfaqes ujore ku do zhvillohet aktiviteti dhe procedurave të trajtimit të produktit deri në treg.

7. shkeljet e lartpërmendura duhet të konstatohen me një akt të veçantë (procesverbal) të mbajtur midis palëve ose përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave ligjore përkatëse, i cili nënshkruhet në prani të tyre.;

8. kontraktuesi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e objektit tek të tretët, duke mos përfshirë këtu shoqëritë e kontrolluara prej saj;

9. kontraktuesi nuk ka të drejtë të lidhë nën kontraktime me subjekte të tjerë;

10. kontraktuesi ka për detyrim, të lejojë dhe të shoqërojë organin kompetent të ngarkuar për inspektim dhe vëzhguesit/monitorët e MBZHRAU të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara nga kontrata, si dhe të kryejnë detyrat funksionale në bazë të legjislacionit në fuqi.

11. Kontraktuesi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë të re ligjore ose ndryshim të dispozitave ligjore ekzistuese në fushën e peshkimit dhe akuakulturës.

12. Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mësipërme të kontratës zbatohen dispozitat ligjore në fushën e peshkimit dhe akuakulturës me masën e gjobës dhe me heqjen e lejes/prishjen e kontratës.

Neni 6

Forca madhore

“Force madhore”do të quhet çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është tej parashikimit dhe kontrollit të drejtpërdrejtë apo tërthorë të palës së cenuar duke i shkaktuar pamundësi të plotë apo të pjesshme palës së cenuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parave).

Rastet e forcës madhore përfshijnë:

- Veprimet e luftës, pushtim, terrorizmin, kryengritjet, grevat në vendin e punës, grevat e përgjithshme apo lokale.

- Rrufeja, zjarri, tërmeti, fatkeqësi të tjera natyrore.

- Çdo akt sabotimi, drejtim i keq, krim i organizuar dhe\ose aktivitete pune që imponojnë apo pengojnë zbatimin e saj.

Pala e cenuar do të përjashtohet nga përmbushja e detyrimit për aq kohë dhe në atë masë sa zgjat pamundësia objektive për të përmbushur detyrimet.

Palët nuk humbasin të drejtën e realizimit të kësaj kontrate. Për këto arsye detyrimisht duhet të përpilohet Aneks- kontrata shtesë në të cilën do të përcaktohen edhe afatet e reja kohore të realizimit të kontratës .

Dokumentimi rastit të forcës madhore të pasqyrohet në procesverbal të miratuar për çdo rast dhe në prezencë të organit të ngarkuar nga ligji për inspektim.

Neni 7

Komunikimi

Komunikimi midis palëve për problemet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate do të bëhet me

shkrim dhe sa herë të jetë e nevojshme, në nivel përfaqësuesish dhe administratorës.

Neni 8

Mosmarrëveshjet

Kjo kontratë është objekt i ligjeve të Shqipërisë, ajo do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm. Të gjitha mosmarrëveshjet e lindura nga ose në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate zgjidhen midis diskutimeve dypalëshe duke arritur një marrëveshje të pranueshme nga palët, pa cenuar vlerat, afatet, kushtet teknike, sanksionet dhe gjokat, në të kundërt palët i drejtohen Gjykatës Administrative Tiranë, vendimi i së cilës është i ankimueshëm në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të Shqipërisë.

Neni 9

Modifikimi dhe zgjidhja e kontratës

Modifikime në këtë kontratë nuk lejohen. Në raste të veçanta çdo modifikim lejohet vetëm pas miratimit me shkrim nga të dy palët dhe përpilimit të Aneks – Kontratës përkatëse shtesë.

MBZHRAU ka drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur kontraktuesi nuk ka shlyer vlerën e taksës së zhvillimit të aktivitetit të përcaktuar në nenin 4 të kësaj kontrate si dhe të tarifës së qerasë për sipërfaqen ujore, brenda afateve të përcaktuara.

Neni 10

Përtëritja e kontratës

Me mbarimin e afatit të kontratës, zona e përcaktuar shpallet për konkurrim publik sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Shfuqizimi i kontratës

Subjektit fizik/juridik i shfuqizohet e drejta e ushtrimit të aktivitetit, me vendim të MBZHRAU, në rastet kur:

- Subjekti fizik/juridik nuk e ka ushtruar të drejtën e aktivitetit të akuakulturës, pa shkaqe të arsyeshme, për një periudhë kohore mbi 6 muaj.
- Subjekti fizik/juridik cenon rëndë mjedisin.
- Subjekti fizik/juridik nuk respekton zonën e caktuar për zhvillimin e aktivitetit të përcaktuar në këtë kontratë.
- Subjekti fizik/juridik nuk realizon, brenda një viti nga çasti i nënshkrimit të kësaj kontrate, vlerën e investimit të parashikuar për vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit sipas dokumenteve (Plan-Biznesit) të aplikimit për leje për zhvillimin e akuakulturës nga subjekti.
- Kur subjekti nuk respekton nivelin e punësimit të deklaruar në dokumentacionin e konkurrit publik.
- Me pushimin së ekzistuari të personit fizik/juridik të cilit i është dhënë e drejta e zhvillimit të aktivitetit të akuakulturës.
- N.q.s. pas nënshkrimit të kontratës vërtetohet me fakte se e drejta e zhvillimit të aktivitetit është dhënë në bazë të të dhënave jo të sakta dhe fakteve të pavërteta.
- Subjekti fizik/juridik nuk plotëson formularin SV-4 të deklarimeve statistikore

Të tjera

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga palë pjesëmarrëse në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, nga të cilat një kopje e mban kontraktuesi.

Kjo kontratë do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj.

PALËT KONTRAKTUESE:

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
Administrimit të Ujërave

Sekretari i Përgjithshëm
Vojo Bregu

Subjekti i Akuakulturës
“.....” shpk

Përfaqësuesi me autorizim/Administratori